

04.02.2021

Ora 17:00

**SEANCË PUBLIKE E KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

**RENDI I DITËS**

**“Për gjetjet e hetimit administrativ në kuadër të shqyrtimit administrativ të denoncimeve për shkeljet e parashikuara në vendimin nr.9, dt.24.12.2020 të Komisionit Rregullator, ndaj Kryetarit të Bashkisë Tiranë, zotit Erion Veliaj”.**

**PJESËMARRJA**

- **KQZ:**

**1.Z. Ilirjan Celibashi**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**2.Stafi KQZ:**

**Z. Y. Merkaj, Znj.M.Koja, Z.E.Meta**

- **Parti politike:**

**Z.E.Salianji (PS), Z.A.Kaziaj (LSI)**

**Z.I.Celibashi:** Mirëmbërma! Atëhere duke ju kërkuar të gjithëve ndjesë për vonesën çelimi sot seancën publike për shqyrtimin administrativ që ka të bëjë me disa kërkesa dhe kallëzime të paraqitura nga partia Lëvizja Socialiste për Itegrim në lidhje me veprimtaritë publike të zhvilluara nga Kryetari i Bashkisë Tiranë. Në cilësinë e Komisionerit Shtetëror për zgjedhjet dhe rrjedhimisht të organit kompetent për shqyrtimin e këtyre kërkesave sikurse përcakton neni 33 i kodit të procedurave administrative, neni 19 pika 1 me gërma m të kodit zgjedhor, kam vendosur fillimisht të bëj bashkimin e të gjitha këtyre kërkesave në një shqyrtim të vetëm administrative dhe rrjedhimisht, përkatësisht të kërkesës me nr. 674 dt. 09.01.2021, të kërkesës me nr.578 dt. 09.01.2021, të kërkesës me nr.570 dt. 09.01.2021, të kërkesës me nr.362 dt. 30.12.2020, të kërkesës me nr. 360 dt. 30.12.2020, të kërkesës me nr.353 dt.30.12.2020, të kërkesës me nr.580 dt.09.01.2021, të kërkesës me nr.406 dt. 05.01.2021, të kërkesës

1

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt. 04.02.2021*

me nr.404 dt.05.01.2021 dhe të kërkesës me nr.562 dt.09.01.2021. Atëhere, palët e interesuara në këtë shqyrtim administrativ, Lëvizja Socialiste për Integrim dhe përfaqësuesit e Kryetarit të Bashkisë Tiranë janë present. Kështu që e deklaroj të hapur shqyrtimin. Përpara se të vazhdojmë dhe të procedojmë me pretendimet e secilës prej palëve dhe mandej në administrimin e provave, keni ndonjë kërkesë paraprake?

**Z. A.Kaziaj:** Nuk kemi i nderuar!

**Z.I.Celibashi:** Përfaqësuesi i Kryetarit të Bashkisë?

**Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së:** Së pari tashmë u njohëm me dokumentacionin e paraqitur nga... me kallëzimin nga Partia Socialiste për Integrim. Kemi një korenspondencë me KQZ-në në lidhje me disa pyetje, por të kemi dokumentacionin e plotë çfarë kërkon. Do dëgjojmë përfaqësuesin e partisë Lëvizja Socialiste për Integrim dhe pastaj do të shprehemi nëqoftëse do të vazhdojmë shqyrtimin ose mund të kërkojmë kohë. Pra, e bëra atë kërkesë që kërkesën për kohë mbasi ta dëgjojmë do shprehemi për vazhdimin e procesit administrativ, meqenëse nuk jemi njohur me kallëzimin e bërë nga ankuesi.

**Z.I.Celibashi:** Mirë, faleminderit! Paraprakisht po ja jap fjalën Sekretarit për të relatuar çfarë në KQZ është paraqitur prej palëve të interesuara në lidhje me këtë proces. Pastaj përfaqësuesit e partisë Lëvizja Socialiste për Integrim dhe më tej sikrse ju thatë rezervoni të drejtën në lidhje me vazhdimin e mëtejshëm të procedimit. Faleminderit!

**Z.Y.Merkaj:** Komisionit Qendror i Zgjedhjeve në dt.12.02.2020 deri në dt. 09.01.2021 i janë raportuar 10 denoncime secili me numer identifikimi të gjeneruar nga sistemi në



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt. 04.02.2021*

ndërfaqen “Aktivitete të ndaluara” në rubrikën “Kallëzo” nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim për veprimtaritë e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ku pretendohet se në llogarinë e tij personale në Facebook janë publikuar disa foto dhe video me qytetarë të ndryshëm duke mbështetur e promovuar objekte të rindërtuara ose në proces ndërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve më datë 18.01.2021 i ka kërkuar informacion mediave nëse e kishte publikuar të transmetuar apo raportuar këto veprimtari dhe aktivitete. Në datë 25.01.2021 gazeta “Panorama” ka kthyer përgjigje në lidhje me informacionin e kërkuar dhe bazuar në njoftimet zyrtare të Zyrës së Komunikimit të Bashkisë Tiranë dhe me emaile të tjera kjo gazetë ka përcjellë njoftimim e shtypit të Bashkisë Tiranë për pesë aktivitete. Më datë 25.01.2021 televizioni “Top Channel” ka kthyer përgjigje për aktivitetet të cilat i ka transmetuar në Edicionin e Lajmeve të orës 15:00. Më datë 25.01.2021 RTSH ka kthyer përgjigje për një aktivitet të transmetuar drejtpërdrejt nga faqja e facebook të Kryeministrit së bashku me Kryetarin e Bashkisë në Zallher në datën 24 dhjetor 2020. Më datë 26.01.2021 Agjensia Telegrafike Shqiptare ka thyer përgjigje se ka pasqyruar aktivitetet e sipërcituara dhe këto aktivitete janë vënë në dispozicion nga Zyra e Shtypit të Bashkisë Tiranë. Subjektet e tjera të cilave u është dërguar kërkesa nuk kanë kthyer ende informacion. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me datë 19.01.2021 i ka kërkuar informacion Kryetarit të Bashkisë për aktivitetet dhe veprimtaritë e denoncuara. Më datë 27.01.2021 Kryetari i Bashkisë ka sqaruar se këto aktivitete nuk kanë patur si qëllim informimin e publikut ashtu sikurse dhe në vendimin nr. 9 të vitit 2020 që Komisioni Rregullator përcakton për transparencën e tij si në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nenligjore për të bërë publik çdo të ardhur donacion apo shfrytëzim në procesin e rindërtimit. Janë aktivitete të zhvilluara në sajë të proceseve të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019. Për të gjitha këto banesa fondi i miratuar, procedurat përkatëse dhe nisja e punimeve ku në një pjesë ka



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt. 04.02.2021*

përfunduar dhe ndërtimi i tyre ka nisur përpara miratimit të vendimit nr. 9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator dhe në respektim të masave të ndërmara për COVID-2-19 janë zhvilluar vetëm me pjesëmarrjen e familjeve përfituese dhe një numri shumë të kufizuar të stafit mbështetës të Bashkisë Tiranë. Sipas Bashkisë Tiranë në asnjë nga këto inagurime banesash individuale nuk kanë qënë të hapura për pjesëmarrjen e publikut. Për sa më sipër, në vlerësim të provave dhe fakteve të mësipërme Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve arrin në konkluzionin se vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qëndror të zgjedhjeve në datën 26.12.2020. Në datën 24.12.2020 Komisioneri Shtetëror i zgjedhjeve ka dërguar kërkesën për përcaktimin e personin përgjegjes për Bashkinë Tiranë dhe institucionet e varësisë në respektim të kërkesave të vendimit nr.9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator. Tre pyetjet që shtrojmë për tu adresuar janë si më poshtë:

A përbëjnë këto veprimtari apo aktivitete, veprimtari publike për tu raportuar? Nëse po, kur fillon afati për raportimin e tyre nga Bashkia e Tiranës?

A kanë këto aktivitete përmbajtje të veprimtarive të ndaluara në kuptim të nenit 3 pika 1.3 të vendimit nr.9 të vitit 2020 të komisionit Rregullator. Në analize të pyetjeve të mësipërme rezulton se Bashkia Tiranë ka adminisrtuar kërkesën në datë 28.12.2020 dhe rrjedhimisht ka marrë dëgjimin për aktin e miratuar. Referuar dispozitave të nenit 104 të Kodit të Procedurave Administrative një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës të cilësisë së drejtorit apo interesavë të cilësisë së prekjes nga momenti kur bëhet njoftimi i përmbajtjes së aktit. Bashkia e Tiranës ka referuar, referuar kërkesave të nenit 4 pika 4 të vendimit nr.9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator. Duke filluar nga data 29.12.2020 i lind deryrimi të raportojë aktivitetet me karakter... me qëllim promovimin e tyre. Për sa më sipër Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve nuk do të procedojë për hetimin administrativ të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt. 04.02.2021*

mosraportimit të aktiviteteve të ndodhur gjatë periudhës 24.12.2020 deri në datën 28.12.2020 dhe respektivisht denoncimet e gjeneruara nga sistemi me nr. ID. 570,574,578 dt.09.01.2021 për shkak se është provuar se këto aktivitete janë zhvilluar në këtë periudhë: 24.12.2020 deri 28.12.2020. Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve do të verifikojë të dhënat dhe rrethanat nëse në këto aktivitete janë kryer veprimtari të ndaluara nga Kryetari i Bashkisë, në kuptim të nenit 3 pika 1.3 e vendimit nr.9 të viti 2020. Pra aktivitetet e denoncuara me nr.ID.353,360,362 dt.30.12.2020 dhe për aktivitete të denoncuara me nr.ID 404,406 dt.05.01.2021, për aktivitetet e denoncuara me nr.ID. 562, 580 dt.09.01.2021 rezulton se këto aktivitete janë zhvilluar përgjatë periudhës 29.12.2020 deri në datën 07.01.2021. Përveç aktivitetit me nr.ID. denoncimi 562 që rezulton i raportuar, të gjitha aktivitetet e tjera rezultojnë të paraportuara në ndërfaqe dhe janë specifikuar në medjat: Gazeta “Panorama ATSH” dhe televizioni “Top channel” me kërkesë të Bashkisë Tiranë. Nga aktivitetet e denoncuara nga Lëvizja Socialiste për Integrim me nr.ID.362 të zhvilluar në datën 30.12.2020 dhe denoncimin me nr.ID.404 për aktivitetin e zhvilluar në datën 05.01.2021 në njoftim është përmendur fakti i dorëzimit të çelsave dhe dokumenteve të shtëpisë. Referuar dispozitave të nenit 2 të vendimit nr.9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator në KQZ dhe nenit 92 pika 1 të Kodit Zgjedhor përcaktohet detyrimi i institucioneve publike, qendrore dhe vendore si dhe agjensive dhe ndërmarjeve shtetërore përfshirë edhe subjektin e denoncuar, të raportojë në komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve. Aktivitetet e denoncuara si aktivitete publike të kryera nga institucioni i Bashkisë Tiranë, një institucion i konsideruar si subjekti raportues sipas nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator duhet të ishin raportuar në ndërfaqet e raportimeve të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve. Referuar nenit 3 paragrafit b i vendimit nr.9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator “Veprimtari

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt. 04.02.2021*

publike janë të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesmarrjen e publikut apo të medias në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim si dhe ato që janë me agjendë informimin në periudhën 4 mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve e publikut të tyre. Në përgjigjet e mara nga mediat, lidhur me raportimin prej tyre të këtij aktiviteti, ftesa për publikim është realizuar përmes Zyrës së Shtypit të Bashkisë me qëllim transmetimin e këtij aktiviteti në televizion ose faqet online të tyre përkatëse. Kështu, edhe pse në momentet e zhvillimit të aktivitetit nuk ka patur prezencë asnjë media, dërgimi i materialit të përgatitur prej Bashkisë Tirane përmes Zyrës së Shtypit, institucioni secilës prej tyre me qëllim transmetimin tek publiku i gjerë dëshmon për përmbushjen e kushtit publik të përcaktuar qartësisht në vendimin nr.9 të Komisionit Rregullator. Për sa më sipër pretendimi i Bashkisë se ky aktivitet nuk ka patur qëllim informimin e publikut ashtu sikurse dhe vendimi nr. 9 përcakton për transparencën e tij si dhe për përmbushjen e detyrimit të përcaktuar nga akti normativ nr. 9 të vitit 2020 për të bërë publik çdo të ardhur, donacion apo shpenzim për procesin e rindërtimit nuk gjendet i bazuar dhe i mbështetur në respektim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator. Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se zhvillimi i këtyre aktiviteteve të ndaluara janë kryer në kundërshtim me nenin 3 pika 1.1 gërma d e vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator. Referuar edhe deklarimeve të administruara me shkresë nr. 2686/1 të protokollit datë 26.01.2021 të Bashkisë Tiranë rezulton e paprovuar nga denoncuesit që fondet e vëna në dispozicion për rindërtimin e këtyre objekteve janë vënë në dispozicion në periudhën e ndaluar nga neni 91 dhe 92 i kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9 i komisionit Rregullator. Përsa më sipër kemi hartuar këtë relacion për gjetjet e hetimit administrativ në kuadër të shqyrtimit administrativ të denoncimeve të subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim ndaj Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Në respekt të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt. 04.02.2021*

kërkesave të nenit 88 është njoftuar Kryetari i Bashkisë për zhvillimin e seancës në ditën e sotme në orën 17:00 për tu dëgjuar në lidhje me pretendimet e tij. Faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Ti japim fjalën përfaqësuesit të Lëvizjes Socialiste për Integrim në cilësinë e personit të interesuar i cili ka prezantuar dhe kallëzimet përkatëse.

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Faleminderit zoti kryetar! Atëhere duke parë intensitetin e dokumentacionit të gjetur në dosje nga ana juaj lidhur me relacionin përkatës dhe denoncimet e ardhura nga ana jonë, pjesën e hetimit administrativ të bërë nga ju, kërkesa për informacion drejtuar mediave audiovizive në këtë rast dhe kthimit të përgjigjes së Z.Veliaj me nr. Protokolli 26\1 datë 26.01.2021, relatojmë se nga ana jonë janë bërë denoncimet ashtu sic dhe relatoi dhe komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm të tij lidhur me veprimtaritë e ndaluara të parashikuara në kodin zgjedhor përkatësisht nenet 92,91 dhe pjesa e akteve rregulluese nëpërmjet Komisionit Rregullator , i referohem këtu vendimit të komisionit Rregullator nr.9 më 24.12.2020 Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe persona të tjerë të përfshirë të administratës së tij, qofshin këta drejtues të Njësive Administrative apo personel administrativ tjetër i administratës, kanë kryer sipas mendimit tonë dhe provave të administruara në dosja të përforcuara këto dhe nga informacioni i ardhur dhe i vënë në dispozicion nga KQZ-ja nga institucionet e mediave le të themi audiovizive, të cilat një gjë të tillë e konfirmojnë.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Datë 04.02.2021, ora 17:30*

**Zoti Altin Kaziaj:** ... relatojmë se: nga ana jonë janë bërë denoncimet ashtu si paraqiti edhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, dhe nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të tij, lidhur me veprimtaritë e ndaluara të parashikuara në Kodin Zgjedhor, përkatësisht nenet 91 e 92 dhe pjesa e akteve rregulluese nëpërmjet Komisionit Rregullator, i referohem këtu vendimit të KRR-së Nr. 9, datë 24.12.2020, Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe persona të tjerë të përfshirë të administratës së tij, qofshin këta drejtues të njësive administrative apo personel administrativ tjetër i administratës, kanë kryer, sipas mendimit tonë dhe provave të administruara në dosje, të përforcuara këto edhe nga informacioni i ardhur dhe i vënë në dispozicion nga KQZ-ja nga institucionet e mediave audiovizive, të cilat një gjë të tillë e konfirmojnë. Ka pasur veprimtari të ndaluara në bazë të vendimeve të Komisionit Rregullator, veprimtari të cilësuar publike, i nderuar zoti kryetar, të cilat i kundërshton fort kryetari i bashkisë; duke qenë së janë shfaqur në të gjitha mediat dhe kemi një feedback konfirmues nga ana e mediave audiovizive dhe nga media e shkruar, në këtë rast, këto veprimtari nuk ka se si të mos hyjnë në nenin 2, pika b, si veprimtari publike të klasifikuara si të tilla nga organi përkatës, në këtë rast Komisioni Rregullator. Po ashtu, veprimtaritë e ndaluara për të promovuar, janë edhe ato të parashikuar në nenin 3 i nderuar zoti kryetar; këtu duhet të bëjmë një ndryshim dhe një saktësim të pjesës së lejimit të veprimtarive nëpërmjet kërkesave që i bëhen Komisionerit nëpërmjet ndërfaqes; po të hidhni nga një shikim sipërfaqësor mbi të gjitha raportimet e bëra në ndërfaqe, për të kryer veprimtari të planifikuara, 90% të tyre nuk përmbushin pikën 4 të nenit 4. Pra, bëhen tej afatit 5 ditor, përpara afatit të planifikimit. Si të tilla, duhen konsideruar si shkelje, për shkak të mos përmbushjes së kësaj pike; dhe të konsiderohen si veprimtari të ndaluara dhe të mos jepet një autorizim i tillë. Për sa i përket pjesës



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Datë 04.02.2021, ora 17:30*

së denoncimeve të bëra, përkatësisht për kryetarin e bashkisë që i referohem, nuk dua të zgjatem me tej me referenca, detaje ose të themi të gjeneruara nga pjesa e identifikimit nga sistemi në këtë rast, siç referoi zoti Merkaj, jemi plotësisht të bindur, përforcuar kjo, siç thashë, edhe nga konfirmimi nga ana e mediave audiovizive, së kryetari i bashkisë ka shkelur vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator, ka shkelur edhe dispozitat e Kodit Zgjedhor, të parashikuara në nenin 92 e 91 të tij. Kështu që, në këtë pikë, duke pasur kohë jo të mjaftueshme në dispozicion për tu shprehur me shkrim, ne, kaq kishim për të relatuar; duke e dëgjuar përfaqësuesin në këtë rast, mendoj se është përfaqësues i bashkisë, meqenëse vetë kryetari i bashkisë nuk ka denjuar për të ardhur; po ashtu sjell në vëmendje të komisionit së ky vendim është kundërshtuar publikisht në datën 17 Janar 2021 nga kryetari i bashkisë në një dalje publike, dhe komisioni nuk është shprehur për këtë duke, ... deri diku, duke ushtruar ndikim mbi Komisionin, dhe mbi vendimmarrjen e Komisionit që është një institucion i lirë, i pavarur dhe që një kryetar bashkie nuk duhet të guxojë për të ushtruar ndikime të kësaj natyre për vendimmarrjen e komisionit. Faleminderit i nderuar zoti kryetar!

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Po, faleminderit! Atëherë ia jap fjalën përfaqësuesit të kryetarit të bashkisë Tiranë.

**Zoti E. Salianji:** Po faleminderit, për sa dëgjova, bërë edhe në relatimin e administratës, si dhe nga përfaqësuesi do të thosha që, në lidhje me, ... për ti dhënë zgjidhje pyetjes së parë dhe pyetjes së dytë se: - a janë publike veprimtaritë, dhe a janë të ndaluara?! ... dhe kjo zgjidh problemin. Për sa i përket shkresës së sjellë nga kryetari i bashkisë, dhe kjo relaton një përgjigje të disa pyetjeve, besoj aty pyetja është kuptuar nga bashkia, -janë bërë me pjesëmarrjen e publikut apo jo?!, dhe prandaj ka ardhur ajo përgjigje, për arsye së nuk ka pasur dijeni për çfarë ishte shqyrtimi administrativ dhe kallëzimi. Po të ishte bashkëngjitur kallëzimi, besoj,



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Datë 04.02.2021, ora 17:30*

do të ishte më e plotë përgjigja. Por përgjigjen e plotësojmë ne këtu në seancë, prandaj bëhet dhe shqyrtimi administrativ. Bërja e veprimtarisë dhe hetimi, që keni bërë ju, i veprimeve të kryetarit të bashkisë, janë veprime të cilat nuk hyjnë tek veprimet e ndaluara. Aty veprimi publik kryhet në kuadër të veprimtarisë së tij të përditshme të punës, dhe hidhet në faqen zyrtare të bashkisë, më pas e kanë marrë mediat dhe e kanë bërë publike. Në përgjigje, bashkia ka thënë se këto veprimtari i kryen duke informuar publikun apo duke informuar median?! Dhe nga shkresa që vjen nga media thuhet se ne i kemi marrë në faqen zyrtare të bashkisë. Kurse, për sa i përket mënyrës së raportimit, do thosha që bashkia Tiranë hapësirën e ka marrë në datë 7, pra këtu kemi të bëjmë vetëm me raportimin; pse nuk janë raportuar? Këto janë veprimtari të cilat lejohen ti kryejë kryetari i bashkisë, janë veprimtari që bëhen edhe publike, mund ti marri media në faqen e kryetarit të bashkisë, por nuk janë të ndaluara. I vetmi veprim që në konstatojmë në këtë proces administrativ është data e publikimit. Në datë 29, sipas relatimit, i ka vajtur njoftimi bashkisë së Tiranës, për personin përgjegjës, që i njofton aktin administrativ; në datën 7 është marrë password-i ku bashkia e Tiranës bën aplikimin; dhe nga ky moment ka filluar të bëjë publikimin; kurse nga data 29 deri në date 7 ka kryer veprimtarinë, por veprimtaritë në kuptim të nenit 3, paragrafi i parë, thuhet : “...veprimtaritë e ndaluara për tu promovuar janë veprimtari publike, ...” dhe në rastin konkret hyn kjo tek veprimtaritë publike, përkufizimi të nenit 2 të këtij vendimi, për të cilat janë dhënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar. Pra, pyetja që mund ti drejtosh bashkisë Tiranë është: kjo veprimtari që, ju keni kryer në datë 29 dhe publikuar në 7, është e vendosur në buxhet rishtas mbas datës 24 apo ka qenë e vendosur, e planifikuar para datës 24 dhjetor 2020? Me sa kam unë informacion këto veprimtari të kryera nga kryetari i bashkisë, janë veprimtari të cilat janë buxhetuar

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Datë 04.02.2021, ora 17:30*

para datës 24/12, bilës mund të kenë 6 muaj më përpara që janë të planifikuar dhe thjesht aty mund të ketë bërë inspektimin e punimeve për mbarimin ose vazhdimin e punimeve për rastet e tjera. Do të thosha që e vetmja provë që në japim që s'është e ndaluar është që këto janë objekte në përfundim. Pra vetë buxhetimi, sikur veprimtaria të ishte bërë në datë 29, buxhetimi duhet të ishte bërë në datë 28. Këto janë të gjitha veprimtari që fondet janë parashikuar para datës 24. Kurse për raportimin, e bëj edhe një herë sqarimin që në datën 7 ka ardhur komunikimi dhe është hapur password-i i bashkisë Tiranë për të aplikuar pranë KQZ-së për të gjithë veprimtaritë. Dhe për sa i përket afatit për tu respektuar veprimtaria e kryetarit të bashkisë është një veprimtari e përditshme dhe besoj nga data 7 e sot që po flasim janë të raportuara të gjitha aktivitetet që bashkia e Tiranës kryen në territorin e saj, dhe nuk përbëjnë asnjë shkak për të marrë ndonjë masë administrative apo së çfarë nuk e di, se edhe kërkuesi nuk e tha, ... shprehu thjesht një ankesë por, që çfarë kërkon në fund që të arrijë komisioneri nuk e kërkoi, ...!!! o ka hequr dorë nga kërkesa thjesht do ta bëjë publike këtë ose nuk e di si ta marr domethënë, ...! e lashë për në fund këtë! së çfarë kërkohet në fund për këto shkelje?!

**Zoti Altin Kaziaj:** Do ju bëj me dije çfarë kërkoj. Ndërkohë, nëse mund të bëj një replikë i nderuar zoti Komisioner me kolegun?

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Mbaruat zoti Salianji?!

**Zoti E. Salianji:** Mbaruam!

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Ok, faleminderit! Po zoti Kaziaj!

**Zoti Altin Kaziaj:** Zoti Salianji flasim për shkelje të përsëritura, dhe është e kotë që kapemi tek pjesa e datave, për mospasjen e aksesit nga ana juaj për të raportuar. Tani, një institucion publik si KQZ-ja, në një moment kaq të rëndësishëm, nxjerr një akt publik në bazë të kodit zgjedhor; Komisioni Rregullator nxjerr një akt nënligjor, i cili rregullon veprimtarinë për mosdhënie të përfitimeve të padrejta një

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Datë 04.02.2021, ora 17:30*

subjekti politik dhe ju thoni: ne s'kemi pasur në dispozicion kohën ose d.m.th. pjesën teknike për të arritur qëllimin, për të publikuar promovimet që keni për të bërë. Kjo nuk ka asnjë lloj kuptimi dhe nuk gjen bazë ligjore. Atë çfarë në kërkojmë është që me drejtësi, duke parë të themi pjesën raportuese me dokumentacion justifikues; duke parë që jemi sot në këtë seancë publike, në kushtet e disa provave të pakundërshtueshme të veprimtarisë publike të pa raportuar, e cila, dhënies së çelësave në dorë të disa qytetarëve në prezencë të disa personave, e të bërë publike në të gjitha mediat më të mëdha të vendit; pra ne, në këto kushte jemi dhe në këto kushte, ne kërkojmë aplikimin e masave të parashikuara në nenin 179 dhe në nenin 10 të sanksioneve të parashikuara në vendimin nr. 9 të 2020-ës. Ka material të mjaftueshëm, ka precedent nëpërmjet një vendimi të Komisionerit dhe ka një precedent në interpretimin e bërë nga KAS-i, se cilat janë veprimtaritë dhe kjo është më se e mjaftueshme.

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Mirë faleminderit! Veç atyre provave që KQZ ka administruar deri më tani secila prej palëve, ka prova të tjera për të paraqitur përpara se të vendosim për mbylljen e shqyrtimit?

**Zoti Altin Kaziaj:** Ne nuk kemi prova të tjera zoti kryetar! Provat janë të mjaftueshme! E përsëris edhe një herë qëndrimin tonë; për sa i përket pjesës publike është çdo gjë publike dhe mund të merret si provë publikisht nëpërmjet mediave; mediat vetë, unë shoh që, kanë pasur një korrespondencë të konsoliduar me institucionin që ju përfaqësoni në këtë rast, dhe kanë sjellë të gjithë dokumentacionin lidhur me pyetjet e ngritura nga ju mbi këto denoncime; dokumentacioni përmban data dhe protokolle, i cili vërteton katërcipërisht bërjen publike dhe dhënien publikisht të disa avantazheve disa qytetarëve në një periudhë që nuk lejohet që kjo gjë të bëhet! Faleminderit!

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Faleminderit! Pra nuk kemi prova të tjera, për të paraqitur!

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Datë 04.02.2021, ora 17:30*

Nga përfaqësuesi i kryetarit të bashkisë, ...?! ... kërkoni që të administrohet ndonjë dokument ose prova të tjera, të cilat nuk janë bërë prezent deri më tani?

**Zoti E. Salianji:** Ne kërkojmë kohë që tua sjellim. Për të përcaktuar që, për secilën veprimtari publike që është marrë pjesë nga kryetari i bashkisë, ne do të sjellim së në cilin moment është buxhetuar dhe prokuruar kjo veprimtari. Me këtë duam të provojmë që nuk jemi veprimtari e ndaluar sipas parashikimit të nenit 3 pika 1 ku thuhet deri në datë 24.12.2020 nuk duhet të prokurosh para 4 muaj para datës së zgjedhjeve. Dhe ne, për secilën veprimtari, sjellim gjithë praktikën e cila është kryer në ditën kur kryetari i bashkisë ka kryer këtë veprimtari. Ne kërkojmë kohë, dhe do ta sjellim në mënyrë shkresore që t'ia bëjmë me dije edhe palës së interesuar. Për veprimtaritë nga data 29 deri në datën e shqyrtimit të veprës, ...

**Zoti Ilirjan Celibashi:** E kuptova, ...!

**Zoti Altin Kaziaj:** Në qoftë së mundem zoti Kryetar!

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Po!

**Zoti Altin Kaziaj:** Do të donim që ky proces të mos zvarritej duke parë edhe momentin aktual në të cilin jemi. Ne kemi këtu një korrespondencë tuajën me zotin Veliaj, i cili, sqaron fare mirë cili është qëndrimi i tij personal. Dhe kjo është mjaftueshëm provë për ne dhe nuk ka nevojë që zoti Salianji të marrë kohë të mjaftueshme në një moment kaq delikat, kur vetë Komisioneri Shtetëror i zgjedhjeve duhet të japi provë, në thonjëza, të një vendimmarrje të drejtë, të një qëllimi që ka pasur ligjvënësi në këtë rast për vendosjen e disa rregullave të mirë përcaktuara, për ndalimin e pasjes së përfitimeve të padrejta të një force politike, kështu që e quajmë të padrejtë këtë kërkesë nga ana e zotit Salianji, duke qenë së kemi prova të mjaftueshme në dosje për të vepruar administrativisht.

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Me sa kuptova unë zoti Salianji kërkon që të sjellë një dokument provues të atyre pretendimeve që janë sjellë me shkrim nga kryetari i

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Datë 04.02.2021, ora 17:30*

bashkisë. Kështu që, në vlerësimin tim, mendoj që kërkesa është e arsyeshme dhe e bazuar. Mendoj që nesër në orën 11:00?!

**Zoti E. Salianji:** Na duhet 24 orë kohë!

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Ai është dokumentacion që e posedoni juve kështu që shumë lehtësisht mund ta merrni.

**Zëri në sallë:** Zoti kryetar janë disa veprime, ... disa dosje, ...

**Zoti Ylli Merkaj:** Kemi nesër në 11:00, ..!!!

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Në 11:00 është mbledhja?!

**Zoti E. Salianji:** Barra e provës i takonte palës, por ne, për një proces të drejtë po e sjellim ne provën, se ne mund të thoshim, ... ishim dhe pasive! Nuk e provon argumentin, ... por që të jemi transparent që jemi në zbatim të ligjit po e sjellim ne provën. Pra duhet të ishte pala tjetër këtu që të kishte ardhur në bashkinë e Tiranës, po të donte të bënte një proces të saktë administrativ dhe ligjor; ti kërkonte bashkisë së Tiranës që si ka, ....

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Zoti Salianji, e konsideruam ,...

**Zoti E. Salianji:** Megjithatë na lini 24 orë! Na duhet për ca veprimtari!

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Atëherë, unë mendoj që nesër në orën 12:00 ta lëmë seancën! Është kohë e mjaftueshme të paktën për të sjellë një prej atyre praktikave të cilat ju i relatuat. Nesër në orën 12:00 seanca! Faleminderit! Për sot seanca mbyllet.

05.02.2021

Ora 12:09

## SEANCË PUBLIKE E KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

### RENDI I DITËS

“Për gjetjet e hetimit administrativ në kuadër të shqyrtimit administrativ të denoncimeve për shkeljet e parashikuara në vendimin nr.9, dt.24.12.2020 të Komisionit Rregullator, ndaj Kryetarit të Bashkisë Tiranë, zotit Erion Veliaj”.

#### PJESËMARRJA

- KQZ:
  - 1.Z. Ilirjan      Celibashi      Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
  - 2.Stafi      KQZ:      Z. Y. Merkaj, Znj.M.Koja, Z.E.Meta
- Parti      politike:      Z.E.Salianji (PS), Z.A.Kaziaj (LSI)
- Përfaqësuesi ligjor i zotit E.Veliaj      Z.Alban Dokushi

**Z.I.Celibashi:** Mirë atëhere fillojmë. Riçelim seancën publike për shqyrtimin e procedimit administrativ që ka të bëjë me kërkesat dhe kallëzimet dhe respektivisht denoncimet e paraqitura nga Lëvizja Socialiste për Integrim në lidhje me aktivitetet e zhvilluara nga Kryetari i Bashkisë Tiranë. Seanca u shty për sot për ti dhënë mundësi përfaqësuesit të Kryetarit të Bashkisë për të sjellë dokumentacion dhe informacion në lidhje me natyrën e aktiviteteve të zhvilluara të regjistruara në kërkesën denoncuese nga ana e subjektit, partia politike Lëvizja Socialiste për integrim. Informacioni përkatës është paraqitur.

**Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së:** Ky është një relacion shpjegues dhe në lidhje me dokumentat dhe relacionin që morëm ne dje nga KQZ-ja.

Zbardhi materialin e inçizuar  
Arlinda BAHOLLARI

**Z.I.Celibashi:** Dakord! Dokumente të tjera për të paraqitur? Nuk kemi. Përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim ka marrë kopje të këtij..?

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Sapo u njoha me dokumentin e sjellë nga përfaqësuesit e Kryetarit të Bashkisë. Shoh që është një dokument voluminoz dhe do të doja kohë për t'u konsultuar me të, për të bërë të themi ato që janë pretendimet ose operacionet tona përkatëse.

**Z.I.Celibashi:** Dakord!

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Në mënyrë që, për të parë gjendjen, për kushtet e barabarta, të na jepet koha e mjaftueshme dhe për tu shprehur me shkrim siç parashikon dhe procedura administrative.

**Z.I.Celibashi:** Mirë, dakord! Atëhere, e pranoj kërkesën tuaj për të marrë kohën e duhur për të shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga përfaqësuesi i Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Ditën e martën në orën 13:30 seanca tjetër. Faleminderit për mirëkuptimin, fundjavë të mbarë!



**SEANCË PUBLIKE E KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

**RENDI I DITËS**

**“Për gjetjet e hetimit administrativ në kuadër të shqyrtimit administrativ të denoncimeve për shkeljet e parashikuara në vendimin nr.9, dt.24.12.2020 të Komisionit Rregullator, ndaj Kryetarit të Bashkisë Tiranë, zotit Erion Veliaj”.**

**PJESËMARRJA**

- **KQZ:**
  - 1.Z. Ilirjan      **Celibashi**      **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
  - 2.Stafi      **KQZ:**      **Z. Y. Merkaj, Znj.M.Koja, Z.E.Meta**
- **Parti**      **politike:**      **Z.E.Salianji (PS), Z.A.Kaziaj (LSI)**

**Z.I.Celibashi:** Mirë atëhere çelim seancën publike të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet për shqyrtimin e dy çështjeve në rendin e ditës. Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të kërkesave dhe të ankesave të Lëvizjes Socialiste për Integrim kundrejt veprimtarive publike të zhvilluara nga Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe pika e dytë e rendit të ditës ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së shoqatës “Për Kulturë Demokratike” për akreditim të vëzhguesve afatgjatë për këto zgjedhje. Mirë, vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të kërkesave dhe ankesave të paraqitura nga Lëvizja Socialiste për Integrim” kundrejt aktiviteteve publike që u dhanë nga Kryetari i Bashkisë Tiranë. Në seancën e shkuar vendosëm për ta shtyrë për sot, me qëllim për ti dhënë kohë përfaqësuesit të Lëvizjes Socialiste për Integrim për tu njohur me materialet dhe dokumentet e depozituara nga Bashkia Tiranë, në lidhje me pretendimet e ngritura. Po, fjala është për ju, përfaqësuesi i partisë Lëvizja Socialiste për Integrim.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt. 09.02.2021*

*Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:* Faleminderit zoti Kryetar! Ditën e sotme është afati që na u dha nga ana juaj për të parashtruar pretendimet tona me shkrim lidhur me atë çfarë përmban dosja administrative që ka të bëjë me shqyrtimin dhe denoncimet e paraqitura nga ana jone kundrejt Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Rreth orës 10:30 është depozituar në protokollin e institucionit tuaj materiali i shkruar. Në vija të përgjithshme për sa u njohëm me materialin dhe me përmbajtjen e këtij dokumentacioni, duke kërkuar nga ana juaj, palëve dhe palëve të treta të themi, bëme me dije Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve që në seancë pikë së pari duam të kishim njohuri mbi legjitimitimin e palëve të cilët kanë ardhur si përfaqësues të zotit Veliaj, Kryetarit të Bashkisë. Nuk e di me çfarë akti, duke ju referuar dhe nenit 38 të Kodit të Procedurave Administrative, kerkuar me shkresë dhe nga ana juaj, ju keni kërkuar vet personin e kallëzuar në këtë rast ose përfaqësuesin ligjor të tij me një prokurë të posaçme të themi, për ta përfaqësuar posaçërisht për këto kallëzime. Ky akt nuk na është vënë në dispozicion. Nga dosja kemi parë që hetimi ka qënë deri diku gjithëpërfshirës edhe nga ana juaj, me iniciatives tuaj për sa i përket pjesës së tagrave që ju njeh ligji, për të çuar më tej të themi një hetim administrativ. Keni kërkuar nga mediat audiovizive ‘RTSH’, ‘TV Klan’, ‘Top Channel’, ‘Ora Neës’, gazeta ‘Panorama’ dhe ‘ATSH’ informacione lidhur me denoncimet tona . Këto informacione ju kanë ardhur me shkrim. Ju citoj që në shkresën nr.6, nr. protokollin dt. 20.01.2021 ‘Panorama Sh.A’ në kthimin e përgjigjes së shkresës tuaj sqaron se në ‘Panorama’ dhe ‘panorama.al’ janë publikuar aktivitetet e kërkuara nga ana juaj dhe të denoncuara nga ana jonë. Është bazuar në njoftimin e komunikimit të Zyrës së Bashkisë Tiranë, e cila për ti bërë publike këto aktivitete, me email zyrtar ia ka dërguar kësaj media, në mënyrë që në faqen e vet ti bënte publicitetin e duhur. Në emailin e datës 5 janar 2021 bashkëlidhur është dërguar nga [bashkiatiranë2012@gmail.com](mailto:bashkiatiranë2012@gmail.com). Dërguesi është Drejtorja e Informacionit të Bashkisë Tiranë. Përmbajtja e tekstit është “Të nderuar kolegë në email do të gjeni njoftimin e

2


*Zbardhi materialin e inçizuar  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt. 09.02.2021*

Kryetari Veliq i cili dha çelsat e 3 shtëpive në Baldushk”, pasqyruar me fotot përkatëse dhe njoftimin bashkëlidhur. Për mos tu zgjatur më tej i nderuar zoti Kryetar i keni të gjitha në faqen e dytë të materialit të sjellë nga ana jonë, të gjitha të specifikuara rastet kur Bashkia me iniciativë ka dashur të japi publicitetin e duhur, duke hyrë në nenin 2 pika b nëqoftese nuk gaboj të veprimtarive publike. Po ashtu në shkresën nr.19/1 të Protokollit Administrativ 01.2021 Top Channel, televizion kombëtar ju ka informuar për 10 nga aktivitetet e kërkuara dhe të denoncuara nga ana jonë që 8 prej tyre kanë pasur publicitetin e duhur në këtë media. Me shkresën 41/1 të 28.01.2021 Agjensia Telegrafike Shqiptare saktëson se janë pasqyruar informacione të dhënë në rrugë elektronike nga ana e Zyrës së Bashkisë së Tiranës, Zyrës së Shtypit në këtë rast. Përforëcohet kështu qëllimi publik që vet Bashkia ka dashur ti japë aktiviteteve të ndaluara duke i bërë atyre publicitetin e duhur në media të caktuara. Me rëndësi të sillet në vëmendje dhe fakti i një qëndrimi publik i denoncuar i zotit Veliq, që ishte dhe në dosjen hetimore, në këtë rast administrative i datës 7 janar 2021, që haptazi e gjen të papajtueshëm këtë qëndrim të KQZ-së nëpërmjet vendimit nr.9 të Rregullatorit, i cili ka dalë në respektim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Duke e shpërfilluar këtë vendim, dhe një deklaratë publike, që kjo e përforcon më tej domethënë faktin që ai ka shpërfillur në vetvete një qëndrim të armëve të barabarta të subjekteve politike që duhet të jetë në afatin 4 mujor nga data e zgjedhjeve që përkon me datën 28 dhjetor. Po ashtu i nderuar zoti kryetar është shumë e thjeshtë që në faqen tuaj të internetit në pjesën e raportimeve në ndërfaqe, një detyrim ky i cili lind edhe nga neni 92 i Kodit Zgjedhor dhe nga neni 4 pika 4 e vendimit nr.9, 2020 nuk ka patur raportime sipas afatit 5 ditor nga raportimi në bërjen e aktivitetit. Raportimet të gjitha janë në një afat më të shkurtër. Pra, një inspektim punimesh që ka patur Bashkia Tiranë, ka raportuar në datën 04.02.2021, ndërkohë që aktiviteti ka ndodhur në datën 05.02.2021. Po ashtu në një inspektim godine i qendrës sociale, raportimi në datën 06.02.2021, aktiviteti në 08.02.2021.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Arlinda BAHOLLARI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Datë 09.02.2021*

**Zoti Altin Kaziaj:** Po ashtu inspektim punimesh në Zallbatar, raportimi në 1 Shkurt 2021, aktiviteti në 4 Shkurt 2021; pra, shihet qartë shpërfillja e detyrimeve që ka pasur subjekti në këtë rast për të raportuar, dhe nuk i ka raportuar. Gjithashtu, i nderuar zoti Kryetar, nga pretendimi në pjesën e shkresës nr. 5402/1, datë 5.02.2021 të kryetarit të bashkisë së Tiranës, vetë i kallëzuarit, indirekt pranon se ka shkelur ndalimin e vendimit të Komisionit Rregullator, nr. 9/2020-të. Ky pranim bëhet nëpërmjet pasqyrit publik që i është dhënë aktiviteteve të kallëzuara nga ana jonë, nëpërmjet publicitetit në mediat më të mëdha në vend. Pra, ky qëndrim sjell, të themi përputhmërinë e kallëzimeve të bëra nga ana jonë. I kallëzuarit flet në përgjigjen e sipërcituar, se administrata e KQZ-së gabon kur konsideron se aktivitetet kanë pasur një qëllim për informimin e publikut. Ftesa për publikun dhe marrja e këtij informacioni në llogaritë në “Facebook” është krejtësisht e ndryshme nga veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut ose të medias. Në ndihmë të kualifikimit publik ose jopublik të daljes në media të kallëzuarit fillimisht, vjen dhe vetë vendimi nr. 9/2020-es, i Rregullatorit, i cili në nenin 2, pika b, e jep qartë nocionin që ka dashur të thotë ligj shkruesi, ose në këtë pjesë le të themi Rregullatori, që është një komision i përbërë nga pesë persona, jep pra qartë nocionin e momentit të veprimtarive publike, d.m.th., që janë të gjitha veprimtari të hapura për pjesëmarrje të publikut apo të media në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim si dhe ato që kanë agjendë informimin për periudhën 4 mujore, para datës së zgjedhjeve, dhe në ditën e zgjedhjeve për publikun rreth tyre. Pra, janë tre faza të ndryshme në kualifikimin e veprimtarive publike. Po ashtu me rëndësi është të theksohet fakti i ndarjes së bërë nga Rregullatori me vendimin në 9/2020-të, të

4

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Datë 09.02.2021*

pikës 1.1 të nenit 3, ashtu e ndarë nga pika 1.3 të nenit 3; i nderuar zoti Kryetar, flasim për veprimtari që lejohet të mbështeten ose promovohen nëpërmjet raportimit në ndërfaqe, dhe flasim për veprimtari krejtësisht të ndaluara, për të cilat nuk ka nevojë as të kërkohet lejimi i tyre për shkak se janë të ndaluara. Për të mos u zgjatur më tej, mendoj se jemi në kushtet e shkeljeve të parashikuara në nenin 10, sanksionet administrative, vendimi 9/2020-të dhe të nenit 171 pika 1 të Kodit Zgjedhor, po ashtu, edhe të nenit 169 të Kodit Zgjedhor. Shtojmë se i kallëzuari mbështet aktivitetet e dosjes administrative si dhe argumentet e sjellë nga ana jonë në proces; si dhe duke parë rastet e përsëritura të këtyre shkeljeve, që përkeqësojnë më tej qëndrimin dhe pozicionin e tij, duhet të sanksionohet nga ana juaj, i nderuar zoti kryetar, me dënimin maksimal të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të nenit 10, sanksionet administrative, të vendimit nr. 9/2020-të, mbështetur kjo në nenin 169 dhe nenin 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor. Faleminderit!

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Po, faleminderit zoti Kaziaj! Atëherë ia jap fjalën përfaqësuesit të kryetarit të Bashkisë Tiranë.

**Zoti E. Salianji:** Faleminderit! Për sa kemi parashtruar gjatë seancave do të thosha shkurt që së pari nuk është veprimtari publike, hedhja dhe postimi në Facebook është...!, ... nuk hyn tek veprimtari të cilat quhen veprimtari publike, dhe këtë arsytim tashmë të sanksionuar edhe nga kolegji i apelimit dhe sanksioneve; për mendimin tim që nga ky moment duhet të rrezohet kërkesa, por edhe nëse do të ishte, nuk bën pjesë në veprimtaritë e ndaluara që parashikon kodi zgjedhor; kjo për arsye se buxheti i këtyre veprimtarive është përcaktuar para datës 24 dhjetor

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Datë 09.02.2021*

2020, datë në të cilën akti ka hyrë në fuqi. Kaq do të thosha dhe kërkoj rrëzimin e kërkesës.

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Po, faleminderit! Paraprakisht, për të sqaruar përfaqësuesin e partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në lidhje me tagrat e përfaqësimit; ne e kemi bërë legjitimimin e palëve që në seancën e parë, edhe për dijeninë tuaj, disponohet, pra, është administruar edhe prokura e posaçme sipas së cilës kryetari i bashkisë autorizon avokat Eridian Salianji dhe zotin Alban Dobrushki për ta përfaqësuar në këtë procedim administrativ. Ndoshta nuk jeni njohur ju, ... por ...

**Zoti Altin Kaziaj:** Nuk ishim në dijeni të këtij dokumenti.

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Faleminderit! Mirë, atëherë meqenëse edhe palët i parashtruan pretendimet e tyre, unë e konsideroj të mbyllur hetimin administrativ, dhe në analizë përfundimtare të fakteve edhe të provave, të paraqitura nga palët si dhe të atyre të administruara pra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar mbi denoncimet e subjektit Lëvizja Socialiste për Integrim. Çmoj se veprimtaritë e denoncuar në KQZ, numrat 353, 360, 362, 404, 406, 562 dhe 580 të zhvilluara nga kryetari i bashkisë Tiranë, pra këto veprimtari përbejnë veprimtari publike për tu raportuar në kuptim të nenit 92, pika 1 e Kodit Zgjedhor, si dhe të nenit 2, shkronja b, e nenit 3 të vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator. Rezulton e provuar që Bashkia Tiranë nuk ka marrë masa aktive për të njoftuar në kohë KQZ-në me email apo me postë, edhe pse pretendoj se ka qenë në mungesë të kredencialeve për raportimin e aktiviteteve publike në ndërfaqen e KQZ-së, si edhe përkundër faktit që bashkia Tiranë, ashtu si edhe institucionet e tjera qendrore dhe vendore

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Datë 09.02.2021*

kanë marrë dijeni për vendimin nr. 9, datë 5.12.2020 të Komisionit Rregullator, si dhe për detyrimet që kanë pasur për marrjen e masave për raportimin e aktiviteteve publike, të paktën që prej datës 28 dhjetor, 2020. Ndaj edhe mos raportimi i tyre në KQZ ngarkon me përgjegjësi administrative kryetarin e bashkisë Tiranë. Për sa i përket pretendimit tjetër, apo grupit të pretendimeve që lidhen me dorëzimin e dokumenteve të shtëpive të rindërtuara, sikurse rezultoi e provuar edhe nga pohimet e vetë institucionit të bashkisë Tiranë, në informacionet shpjeguese që ata kanë prezantuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vërtetuar kjo me shkresën nr. 2686/1 date 26.01.2021, çmoj se përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, pika 1/3 germa b të vendimit nr. 9, date 5 dhjetor 2020 të Komisionit Rregullator, dhe e ngarkon kryetarin e bashkisë Tiranë me përgjegjësi administrative. Për sa i përket pretendimeve që lidhen me inspektimin e punimeve për objektet të cilat janë në kuadër të projektit të rindërtimit, çmojmë se këto pretendime nuk kanë besueshmëri ligjore në vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, pasi, sikurse rezultoi e provuar, nga dokumentacioni që ka administruar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhe përderisa nuk u provua e kundërta edhe nga pala e cila ngriti pretendimet, rezultoi se këto janë aktivitete për të cilat janë parashikuar para datës 25 dhjetor 2020, ndaj për këto veprimtari nuk rezultoi që të ketë përgjegjësi nga ana e kryetarit të bashkisë Tiranë.

Për këto arsye, bazuar në nenin 19, pika 1 shkronja f, dh dhe n, si dhe pika 2, si dhe nenet 91, 92 dhe 171, pika 1 të ligjit nr. 10019, date 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, si dhe nenet 17, 18, 19 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe nenet 3 dhe 10 të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator,

Vendos:

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Datë 09.02.2021*

1. Sanksionin administrativ me gjobë ndaj zotit Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë, në shumën e 35 000 lekëve për shkelje të nenit 92, pika 1, 2 dhe 3 të ligjit 10019, datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, për mos raportim të aktiviteteve publike.
2. Sanksionin administrativ me gjobë ndaj zotit Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë, në shumën e 40 000 lekëve për shkelje të nenit 3, paragrafi 1/3, shkronja b të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.
3. Ky vendim përbën titull ekzekutiv. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Faleminderit!

Mbyllet kjo pikë e rendit të ditës, dhe do të vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së Shoqatës për Kulturë Demokratike, për akreditim të vëzhguesve afatgjatë.

**Zoti E. Salianji:** Ditë të mbarë!

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Ditë të mbarë!

*(Dëgjohet një komunikim verbal pa mikrofon)*

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Ne lexuam vetëm shkurtimisht dhe në mënyrë të përmbledhur arsyetimin e vendimit. Mirë u pafshim!

**Vendimi nr.46**

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Datë 09.02.2021*

9.02.2021

Ora 13:55

**RENDI I DITËS**

*Për miratimin e kërkesës së Shoqatës për Kulturë Demokratike, për akreditim të vëzhguesve afatgjatë në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021*

**PJESËMARRJA:**

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      Z. Ilirjan Celibashi

2. Stafi i KQZ:      Z.Y.Merkaj, Znj.E.Jorgaqi, Znj.M.Koja, Znj.Dh.Kërçani

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Fjala është për ju zoti Sekretar i Përgjithshëm, për të relatuar projektaktin.

**Zoti Ylli Merkaj:** Atëherë shoqata për Kulturë Demokratike i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 34 vëzhguesve afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre, për vëzhgimin e zgjedhjeve të datës 25 prill 2021. Shoqata për Kulturë Demokratike është një organizatë që punon në fushën e zgjedhjeve dhe të drejtave të njeriut dhe ndjek në vazhdimësi zhvillimin e proceseve zgjedhore dhe si e tillë gëzon të drejtën për të vëzhguar zgjedhjet për kuvend të datës 25 Prill 2021. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatoj se është në mbështetje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor si dhe nenin 4 të udhëzimit nr. 2 të vitit 2021, për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat jo-qeveritare shqiptare dhe të

1

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Datë 09.02.2021*

huaja. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e vëzhguesve. Faleminderit!

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Mirë! Faleminderit! Atëherë meqenëse kërkesa e organizatës “Shoqata për Kulturë Demokratike” është e bazuar në Kodin Zgjedhor dhe udhëzimit përkatës të KQZ-së,

Vendos:

1.Të miratoj kërkesën e Shoqatës për Kulturë Demokratike për akreditimin e 30 vëzhguesve afatgjatë për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për kuvend të datës 25 prill 2021, sipas listës bashkëlidhur në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe do të publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Mirë! Mbyllet dhe kjo pikë e rendit të ditës dhe me këtë rast mbyllet dhe seanca publike e ditës së sotme. Faleminderit!

**Vendimi nr.45**

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*

